



1.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

KOMISIONI PËR VLERËSIM TË PRONËS KOMUNALE GJATË DHËNIES NË SHFRYTËZIM OSE SHKËMBIM

Komisioni i themeluar me Vendim të Kuvendit Komunal të Dragashit, 01nr.060/01-5552-2/22 të datës 31.03.2022, bazuar në nenin 4,5,6, 8.1.1 dhe nenin 15 të ligjit 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, dhe në bazë të neneve 4,5,8,9 dhe 10 të Rregullores QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave të paluajtshme komunale, në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal 01nr.060/01-7575-4/22 të datës 28.04.2022, pas shqyrtimit të Komisionit për vlerësim..., më date 28.06.2022, shpall:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

Për dhënien e pronës së paluajtshme komunale - lokaleve afariste, në shfrytëzim të përkohshëm.

Lënda e ankandit publik:

- 1. Byfeja Komunale në kuadër të objektit të Komunës** parcela kadastrale P-70604014-00809/1 ZK Dragash, Sheshi i Dëshmorëve Dragash; sipërfaqja e lokalit: 3.5x4m total 14m²; Qëllimi i aktiviteteve të Byfësë komunale është shërbimi i kafesë, pijeve të nxehta dhe të ftohta, për punëtorët e komunës dhe palët; afati i dhënies në shfrytëzim - 5 vjet; **çmimi fillestar 25 €;**
- 2. Lokali afarist, deri më tani i regjistruar me emrin "Morena"** në kuadër të ndërtesës, parcela kadastrale P-70604014-00781-0 ZK Dragash, rruga Sheshi i Dëshmorëve Dragash, sipërfaqja e lokalit: 39m² dyqan dhe 21m² depo gjithsej 60m², lokali nr.; afati i dhënies në shfrytëzim - 5 vjet; **çmimi fillestar 200 €;**
- 3. Lokali afarist deri më tani i regjistruar me emrin "Jeta Pharm"** në kuadër të ndërtesës në parcelën 70604014-00781 ZK Dragash, Sheshi i Dëshmorëve Dragash; sipërfaqja e lokalit: 27.3 m² lokal dhe 16 m² depo, gjithsej 43.3 m²; afati i dhënies në shfrytëzim - 5 vjet; **çmimi fillestar 180 €.**

KRITERET, AFATET, PROCEDURAT DHE KUSHTET

- Kriteri fitues i ankandit - **çmimi më i lartë i ofruar;**
- Afati për dorëzimin e ofertave: brenda 15 ditëve nga shpallja e ankandit publik, në vebfaqen e Komunës, gjegjësisht në mediat publike, në tabelën e shpalljeve të Komunës së Dragashit, pra nga 28.06.2022 dhe zgjat deri në 13.07.2022. si afat i fundit i paraqitje së ofertave. Përparësi kanë përdoruesit e deri tanishëm që kanë vepruar në përputhje me detyrimet sipas kontratës.
- Përmbajtja e ofertës: Shënimi i hapësirës afarista-lokalit për të cilin personi juridik apo fizik është i interesuar, siç është përshkruar më sipër, çmimi i përcaktuar qartë, aktiviteti që do të kryhet, numri i telefonit kontaktues dhe adresa e ofertuesit - Oferta për ankand publik mund të paraqesin të gjithë personat fizikë dhe juridikë. Nëse bëhet fjalë për kompani/biznes apo ndërmarrje, kërkohet licencë.

- Dorëzimi i ofertave: Ofertat në zarfe të mbyllura do të dorëzohen përmes Zyrës së Pranimi drejtuar Komisionit Vlerësues për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale të Dragashit. Ofertat dorëzohen në zyrën e pranimi dhe dorëzohen me një tarifë prej 10,00 €. Ofertës duhet ti bashkëngjitet edhe një dëshmi të lëshuar nga Drejtoria e Financave se ofertuesi nuk ka borxhe ndaj Komunës së Dragashit.
- Hapja e ofertave / Ankandi Publik do të bëhet më **18.07. 2022** në sallën e Kuvendit Komunal në ora 10:00. Sipas nevojës mund të ndryshohet vendi i mbajtjes së Ankandit.
- Formularët e ofertës mund të merren në shërbimin e pranimi të Komunës së Dragashit.

PËRKUFIZIMET

Ofertat të cilat nuk do të konsiderohen apo pranohen, pavarësisht nga çmimi i ofruar:

1. Nëse pjesëmarrësi në Ankandin Publik nuk e ka dorëzuar dëshminë e lëshuar nga Drejtoria e Financave, se ofertuesi nuk ka borxhe ndaj Komunës së Dragashit, në bazë të tatimit, ose obligimet tjera.
2. Nëse i referohet veprimtarisë së shërbimit të alkoolit etj.

TË DREJTAT E PJESËMARRËSVE TË ANKANDIT DHE TËRHEQJA NGA OFERTA

- Personi fizik apo juridik i interesuar për ofertuar ka të drejtë të informohet për procedurën e ankandit publik, të ketë qasje në dokumentacionin kadastral dhe pronësor në lidhje me lokalit dhe qasje fizike në lokal për ta shikuar.


Secili ofertues mund të tërhiqet nga ankandi publik ose të tërhiqet nga oferta jo më vonë se 3 ditë para hapjes së ofertave - mbajtjes së ankandit publik.

Ky njoftim do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Dragashit në përputhje me alinejen nga paragrafi 2 - Kriteret, afatet, procedurat dhe kushtet do të shpallen në vebfaqen zyrtare të komunës së Dragashit, në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe të paktën në një nga mediat elektronike.

Dragash; 28.06. 2022

Anëtarë i autorizuar i Komisionit:

Isljam Redzeplari



Kryetari i Komunës

Dr. Bexhet Xheladini

